



“Këndet e librave”

Thirrje për aplikim

Qëllimi

“Këndet e librave”, është aktiviteti i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës, në përputhje me kërkesat e lexuesve dhe shitëseve të librave, me synim të krijimit të dy këndeve të bukura dhe funksionale për shitjen e librave.

Rregullat e Këndit të librave

1) Vendi dhe orari i punës

Shitja e librave në shtëpizat e vendosura në sheshet “Zahir Pajaziti” dhe “Nënë Tereza”, do të fillojë menjëherë pas përzgjedhjes së shfrytëzuesve të shtëpizave. Shfrytëzuesit e shtëpizave do të lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna deri në të dielën, duke filluar nga ora 09:00 deri në 20:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e shfrytëzuesve të shtëpizave në këndet e librave, do të bëhet nga një komision i posaçëm, i formuar nga Kryetari i Komunës së Prishtinës. Pasi që numri i shtëpizave do të jetë i kufizuar, janë vendosur kriteret e paraqitura më poshtë, në mënyrë që përzgjedhja e shfrytëzuesve të bëhet sa më e drejtë dhe transparente.

Kriteret bazë:

- Shitësit individualë të sjellin dëshmi se kanë shitur libra në sheshet e kryeqytetit së paku për tri vitet e fundit (dokument nga Drejtoria e Shërbimeve Publike);
- Shtëpitë botuese të jenë të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe të jenë të pajisur me arkë fiskale;
- Shtëpitë botuese të sjellin dokumentin, i cili dëshmon se i kanë të kryera obligimet tatimore ndaj ATK-së.

Kriteret shitesë:

- Shitësit individualë duhet të dëshmojnë kontratat/bashkëpunimet (nëse kanë të tilla) me shtëpi botuese;
- Shtëpitë botuese të dëshmojnë numrin e botimeve/editimeve të librave të rinj në tri vitet e fundit;
- Shtëpitë botuese duhet të dëshmojnë kontratat/bashkëpunimet (nëse kanë të tilla) me shtëpi të tjera botuese brenda dhe jashtë vendit;
- Përparësi do të kenë shitësit individualë.

Aplikuesit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- Certifikata e numrit të regjistrimit të biznesit (për shtëpitë botuese);
- Certifikata e numrit fiskal të biznesit (për shtëpitë botuese);
- Kopja e letërnjoftimi të aplikuesit;
- Të dhënat e aplikuesit: nr. i telefonit, E-mail adresa.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave në këndet e librave, janë përcaktuar duke u bazuar në Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, (Rregullorja nr. 011102782/2011), ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Shfrytëzuesit e shtëpizave do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej 10 euro në muaj për m² për periudhën e shfrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Ndarja e shtëpizave

Numri i përgjithshëm i shtëpizave është tetë (8), ku secila do të shënohet me numrin përkatës. Ndarja e shtëpizave do të bëhet menjëherë pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes.

5) Kodi i mirësjelljes dhe obligimet shitesë

Të gjithë shfrytëzuesit e përzgjedhur janë të obliguar të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre.

Për zbatimin sa më të mirë të këtij projekti, Komuna e Prishtinës ndalon rreptësishtë aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda këndeve të librave;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave që do të shfrytëzojnë shtëpizat, të blerësve apo kalimtarëve të rastit;
- Shitjen e produkteve që nuk parashihet të shiten në këto shtëpiza;
- Të gjithë shfrytëzuesit obligohen të mirëmbajnë hapësirën brenda dhe jashtë shtëpizës.

- Shfrytëzuesit e shtëpizave obligohen që librat t'i shesin me çmimin e tregut.

Nëse evidentohen shkelje të kodit të mirësjelljes dhe obligimeve, atëherë do të revokohet leja për gjithmonë për shfrytëzimin e shtëpizave.

Aplikacionet mund të dorëzohen prej datës 20 korrik deri më 28 korrik 2017, në zyrën pritëse, nr. 1 në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër).